

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Charlie's Angels" rikthehen dhe mahnitin të gjithë! Tre ikonat shfaqen bashkë në Emmy! Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/charlies-angels-rikthehen-dhe-mahnitin-te-gjithe-tre-ikonat-shfaqen-bashke-ne-emmy/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 13:46:26 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 13:46:02 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	15d9bb29e3173002d3744210e4d1d99c371a657fffe271715a7898eb558602ca
TEKSTI	50198bac99505acbf4755c84b01500eb5c6d03d53730879aa4def96844cba54f
PAMJA	106064b92473adf915a0d655d760d1347ee8da7c837e2bfbbc40e61a52676bdf

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e206204a5275faefbfbcc807f0e801d58407c9c6e0216582a9422fd48a3137a7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	30dbb60d3d02cfc881d14f9729132b5faa86f341ad579020b2892f9612d800a7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/e206204a5275faefbfbcc807f0e801d58407c9c6e0216582a9422fd48a3137a7

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Celebrities Gossip Showbiz

“Charlie’s Angels” rikthehen dhe mahnitin të gjithë!
Tre ikonat shfaqen bashkë në Emmy!



Redaksia K

15 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Pas pesë dekadash, “engjëjt” u rikthyen sërish në skenë, dhe emocionet nuk munguan. Kate Jackson, Jaclyn Smith dhe Cheryl Ladd u ribashkuan në ceremoninë e Emmy 2026, për të festuar 50-vjetorin e serialit legjendar “Charlie’s Angels”. Tre aktoret u pritën me duartrokitje të fuqishme teksa dolën në skenën e Peacock Theater në Los Angeles për të prezantuar çmimin për serialin më të mirë dramatik.

Të treja u shfaqën elegante dhe në formë, duke rikthyer për pak çaste atmosferën e serialit që u bë një fenomen televiziv në vitet '70.

“Charlie’s Angels” debutoi në vitin 1976 dhe u transmetua deri në vitin 1981. Në kastin fillestar ishin Jaclyn Smith, Kate Jackson dhe Farrah Fawcett, ndërsa Cheryl Ladd iu bashkua serialit në sezonin e dytë, pas largimit të Fawcett.

Ribashkimi në Emmy kishte edhe një dimension emocional. Aktoret nuk harruan kolegen e tyre të ndjerë, Farrah Fawcett, e cila ndërroi jetë në vitin 2009 pas një beteje me kancerin.

Ishte Jaclyn Smith ajo që e përmendi fillimisht Fawcett, duke thënë se dëshironte të nderonte “një person që nuk është këtu me ne sonte.

Ajo vijoi me një nga momentet më prekëse të mbrëmjes:

“ Siç kam thënë shumë herë, karizma nuk ka nevojë për një sezon të dytë. Ajo është këtu dhe është me ne në kujtesën kolektive të të gjithëve.

Kate Jackson e quajti Fawcett “engjëllin më të ndritshëm nga të gjithë”, duke kujtuar se ajo ishte dashur nga miliona njerëz në mbarë botën dhe vazhdon të jetë e tillë edhe sot.

“ Nuk do ta harrojnë kurrë, dhe as ne nuk do ta harrojmë

-tha Jackson.

Cheryl Ladd, ndërkohë, solli një dozë humori në momentin emocional, duke iu referuar posterit ikonik të Fawcett me kostumin e kuq të banjës, i cili u bë një prej imazheve më të famshme të kulturës pop të viteve '70.

Pas këtij momenti nostalgjik, tre aktoret prezantuan çmimin Outstanding Drama Series, i cili iu dha "The Pitt".

Rikthimi i tyre ishte veçanërisht domethënës pasi "Charlie's Angels" konsiderohet një prej serialeve që ndryshuan mënyrën se si gratë paraqiteshin në televizionin amerikan. Tre protagoniste femra ishin në qendër të aksionit, duke ndjekur kriminelë dhe duke përballuar rrezikun, në vend që të prisnin të shpëtoheshin.

Jaclyn Smith e ka përshkruar ndikimin e serialit si një moment kur gratë u panë si "të pavarura, jo të përcaktuara nga burri në jetën e tyre".

Edhe pse kanë kaluar 50 vite nga premiera, "Charlie's Angels" vazhdon të ketë një vend të veçantë në kulturën pop. Seriali u nominua katër herë për Emmy dhe frymëzoi më vonë filmat "Charlie's Angels" të vitit 2000, "Charlie's Angels: Full Throttle" në 2003 dhe reboot-in e vitit 2019.

Për fansat, megjithatë, ajo që ndodhi në Emmy ishte më shumë se një prezantim çmimi.

Ishte një rikthim pas gjysmë shekulli i tre grave që ndihmuan në krijimin e një prej serialeve më ikonike të televizionit, dhe një kujtesë e bukur se, edhe pse një pjesë e "engjëjve" mungonte në skenë, kujtesa për Farrah Fawcett vazhdon të jetë po aq e gjallë sa 50 vite më parë.

LAJME TË NGJASHME



50 vjet më vonë, yjet e "Charlie's Angels" ribashkohen dhe kujtojnë serialin që u kthye në fenomen!

2.5 MIN



80 vjeçe dhe mahnitëse! Ikona e 'Charlie's Angels' zbulon sekretin e rinisë!

1.5 MIN



Pas 14 vitesh ylli i "Charlie's Angels", Kate Jackson bëhet e "gjallë"!

1 MIN

MË TË LEXUARAT





Biletat për ndeshjet e Shqipërisë, edhe fizikisht pranë "Air Albania"-s!




Oasis nuk ndalen! Liam dhe Noel Gallagher rikthehen sërish në skenë me 38 koncerte?



Arresti i Erion Veliajt, sot çështja në Gjykatën e Lartë!



"Burri e tradhtonte me shokun e ngushtë..." Shkënda Lili habit me rastin: Kishte kapur disa foto intime në...



Rrëzohet kërkesa e Ilir Metës për lirim nga burgu!



Kujtimet në Top Channel dhe dashuria për ekranin, "rikthehet" Albana Osmani: Do të doja të bashkëpunoja me Ledionin...



Sydney Sweeney pozon nudo për reklamën e re dhe shpërthen polemika? "Po seksualizohet sporti..."



Për kë vazhdon të blejë lule te dyqani i motrës së Stelinës? Miri zihet ngushtë: Për atë...



Makina përplas 69-vjeçarin me biçikletë, ndërron jetë rrugës për Tiranë!



"E ëma e qëllloi me gur për ta vrarë", Pastor Vilajti rrëfen historinë e fëmijës që shpëtoi!

EDITORI SUGJERON



Sasia ideale e proteinave që duhet të hani në mëngjes, sipas një dietologu...



4 kardiologë tregojnë ushqimet që konsumojnë rregullisht për të ndihmuar në uljen e tensionit dhe...



7 ilaçe që mund të ndërveprojnë me çajin jeshil?!



Tom Holland bën histori në Hollywood, bëhet aktori me filmat më fitimprurës të të gjitha kohërave!



Pyetëm një dietolog nëse yndymat e kikirikëve janë të mira për zemrën?! Ja se çfarë tha...



"Seven Up!" i jep lamtumirën kamerës pas 62 vitesh, fëmijët që u filmuan në moshën 7-vjeçare festojnë 70-vjetorin!



Çfarë mund të ndodhë nëse hani avokado rregullisht?!



Cili është lloji më i mirë i drithërave për të ulur kolesterolin?!



Koha më e mirë për të ngrënë kumbulla të thata për tretje më të mirë!



7 mënyra të shëndetshme për t'i dhënë shije të ëmbël tërshërës...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana,

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top

LINKS

Kontaktimi

zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

Albania

Email:

Tel: +355 69 208 0500

+355 69 442 8873

Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

Marketing

Frekuencat

Aksesueshmëria

Mundësi Punësimi

Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for tabnav widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.